

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
"DIGITAL MARKETING CM" SHPK
KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 27/05/2024 (dymijë e njezet e kater) personat e meposhtem:

- 1- Z.Jorin MITRAJ ,e datëlindjes 23/08/1988 lindur ne Fier dhe banues në Tirane , madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetase Shqiptare, mbajtës i dokumentit , Kartes se identitetit Nr. **Personal:I80823071F** në cilësinë e "Ortakut Themelues", me vullnet te lire te plote e te singerte, dhe inisiativen e lire pivate, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", vendosen te themelojne shoqerine tregtare, me pergjegjesi te kufizuar, me emertimin "**DIGITAL MARKETING CM**" SHPK. Shoqeria do te kete emer tregtar '**DIGITAL MARKETING CM**'SHPK

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

**Neni 1
Emri dhe Ortaket**

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me pergjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin "**DIGITAL MARKETING CM**" SHPK.
1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

**Neni 2
Objekti**

Shoqëria "**DIGITAL MARKETING CM**" "SHPK ka si objekt të veprimtarise te saj, zhvillimin e aktiviteteteve si me poshte"*Marketing Online. Gjithashtu shoqeria mund te ushtroje edhe çdo lloje aktiviteti te pa shprehur me siper,qe lejohet nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.*

**Neni 3
Kohëzgjatja**

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per nje afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
3.2 Shoqeria "**DIGITAL MARKETING CM**" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKR-se.

**Neni 4
Zyra Qendrore**



- 4.1 *Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën: Tirane,Njesia Administrative nr 7,Rruga Naim Frasheri,Nr Pasurie 47/1 ,shkalla 2,Zone Kadastrale 8210 ,Tirane.*
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksionit te vendit perkates.

KREU III

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **500.000 Lek** (Peseqind mije lek), i barabarte me 1 (nje) kuote. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesëmarrja e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	JORIN MITRAJ	1	500 000	100%
Totali		1	500 000	100 %

- 5.3 Kontributet sa me siper do te shlyhen ne periudhat e mevoneshme.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimit e ortakëve të rinj në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëve në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji per Shoqerite Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndermjet paleve.



- 7.2 Transferimi i kuotave te ortakeve te shoqerise brenda ortakerise apo ne drejtim te personave te trete jashte ortakerise eshte i kushtezuar ne cdo rast nga miratimi i asamblese se pergjithshme te ortakeve sipas kuorunit te nevojshem te percaktuar me poshte.

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtari ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruesve të kuotave, do të jenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjerë.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuara nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gëzonte zotëruesi i kuotës, duke përfshirë të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit në QKR.

Kreu IV

Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarrës i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;



- h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
- i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
- j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
- l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
- m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
- n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligji per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryer regjistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht.

- 9.2 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e përmendura në pikat (g) dhe (h) me sipër pas shqyrtimit të dokumentacionit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.
- 9.3 Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortakët e minorancës sipas dispozitave të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkresë, me postë ose e-mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përpara datës së caktuar për mbledhjen përveç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtër është miratuar nga të gjithë ortakët që zotërojnë 100% të kapitalit të shoqërisë.
- 9.4 Njoftimi për thirrjen e Asamblesë duhet të përmbajë në mënyrë të qartë datën, ditën, kohën, vendin dhe rendin e ditës të mbledhjes, së bashku me dokumentacionin përkatës dhe do t'u dërgohen të gjithë Ortakëve të Shoqërisë të paktën 7 (shtatë) ditë përpara mbledhjes.

Në rast ndryshimi të rendit të ditës, do të ndiqet e njëjta procedurë njoftimi që përshkruhet më sipër.

Neni 10

Kuorumi i nevojshëm

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 50 për qind të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë jo më pak se 51 për qind të kapitalit të shoqërisë.



- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Ortakeve vendos me 3/4 të ortakëve zoterues të kapitalit të shoqërisë me të drejta vote, për çështje të rëndësishme që kanë të bëjnë me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera të zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimi jepet në formë shkresore vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme dhe është i vlefshëm edhe për mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- 11.4** Kryetari i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të jetë administratori i shoqërisë i cili do të drejtojë mbledhjen dhe asambleja e përgjithshme në çdo mbledhje të saj do të emerojë me shumicë të thjeshtë të votave të ortakëve pjesëmarrës edhe një person tjetër për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes së asamblese së përgjithshme.
- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes së asamblese së përgjithshme do të regjistrohet në proces-verbal, i cili do të mbahet në përputhje me nenin 90 të ligjit Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare.

Neni 12

Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotëruesit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votës bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit për shoqëritë tregtare në fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar



prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit

13.1 Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave të ortakeve në Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

13.2 Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë **"DIGITAL MARKETING CM" SHPK: Z/Jorin Mitraj**, atësia Dhosi, i datëlindjes 23.08.1988, lindur në Fier, banues në Tiranë, Shqipëri, madhor, me zotësinë e plotë për të vepruar, shtetas Shqiptar, mbajtës i dokument Kartes së identitetit **Nr. Personal: 180823071F, per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij akti prane Qendres Kombetare te Regjistrimit.**

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

14.1 Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me sipër dhe ligjit tregtar në fuqi.

14.2 Pa u kufizuar sa me sipër, në mënyrë të veçantë, Administratori ka këto kompetenca:

- (i) do të drejtojë dhe të përfaqësojë Shoqërinë përse i përket administrimit të zakonshëm;
- (ii) do të nënshkruajë çdo marrëveshje në emër të Shoqërisë;
- (iii) do të hapë llogari në emër të Shoqërisë me çdo bankë që kryen aktivitet në Shqipëri ose jashtë saj,
- (iv) do të përgatitë të gjitha planet për marrjen e financimeve, do të nënshkruajë çdo kontratë huaje apo kontratë tjetër që parashikon një borxh apo borxh të mundshëm për Shoqërinë, hipoteke, peng apo çdo marrëveshje tjetër që krijon apo mund të krijojë një barri mbi pasuritë e Shoqërisë, marrëveshje garancie, kontratë për shitjen e pasurive të paluajtshme apo të luajtshme të Shoqërisë. Të gjitha veprimet e parashikuara këtu (pika iv) do të jenë të vlefshme nëse janë të autorizuar shprehimisht me anë të një Vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë unanime;
- (v) do të urdherojë dhe kryejë pagesa në emër të Shoqërisë – duke nënshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do të kujdeset për mbajtjen e sakte e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabel të Shoqërisë;
- (vii) do të përgatitë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku



me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;

- (viii) do te krijoje nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoqerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te dhenave te Shoqerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te veçante per veprimtarine e Shoqerise;
- (xi) do te pergatise te gjitha planet per zhvillimin dhe operimin e Hidrocentraleve;
- (xii) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoqerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xiii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoqerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me sipër, ka të drejtë të ngrejë padi përpara gjykatës kompetente për shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose padi të tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuan ose mund të vuajë nga çrregullime mendore;
3. ndodhet ose mund të ndodhet në kushtet e pa-aftësisë fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoqerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet në situata apo rrethana të cilat e bëjnë të pamundur ushtrimin e detyrave të tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

16.1 Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çështje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit për shoqerite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqërie, në bazë të kuorumit të kërkuar, autorizon lidhjen e kësaj marrëveshje.



- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
 - b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedurës së falimentimit;
 - c) në rast se objekti bëhet i përealizueshëm për shkak të mosfunksionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
 - ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 të ligjit për shoqëritë tregtare;
 - d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
 - dh) në raste të tjera, të parashikuara me ligj;
 - e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.
- 17.2** Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.
- 17.3** Administratori është i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKR, me përjashtim të rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; në këtë rast është gjykata që i dërgon njoftimin QKR-se.

Neni 18 Njoftimet

- 18.1** Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.



Administratori është i detyruar të administrojë të dhenat e ortakeve (nr.tel, email, adrese banimi etj) në një regjister të posaçëm dhe ortakët janë të detyruar të njoftojnë gjithmone administratorin për çdo azhurnim të këtyre të dhënave brenda ditës, në të kundërt mbajnë përgjegjësi për demin e shkaktuar.

- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike që i është njoftuar shoqërisë nga ortakët. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19 Te Ndryshme

- 19.1** Çdo dokument që leshohet për dhe në emër të shoqërisë është i pavlefshëm nëse nuk mban vulën e saj.
- 19.2** Të gjitha marrëdhëniet e punës në shoqëri rregullohen me Kodin e Punës dhe çdo akt tjetër ligjor dhe nenligjor të zbatueshëm të Republikës së Shqipërisë, në fuqi dhe në veprim kohë pas kohë gjatë periudhës së ushtrimit të aktivitetit të saj tregtar.
- 19.3** Viti financiar zgjat 12 (dymbëdhjetë) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të çdo viti.
- 19.4** Në fund të çdo viti financiar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, të cilet i dërgohen për miratim Asamblesë së zakonshme.
- 19.5** Për të gjitha çështjet që nuk janë parashikuar në këtë Statut, do të zbatohen parashikimet e Ligjit për Shoqëritë Tregtare në fuqi, të azhurnuar.

NENI 20 Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut përben dokumentin e vetëm të shoqërisë që parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarisë së shoqërisë. Ky Statut mund të ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjesërisht ose teresisht dhe të zëvendësohet me një statut të ri vetëm me vendim të Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve sipas shumicës së cilesuar të përcaktuar me sipër.
- 20.2** Për sa nuk është parashikuar në këtë statut, ortakët do të referohen legjislacionit tregtar Shqiptar në fuqi si dhe praktikave tregtare në vend.

Ky statut u redaktua në 4 ekzemplare, me përmbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën Shqip dhe u nënshkrua nga palet pa asnjë rezervë.

ORTAKU THEMELUES

Jorin MITRAJ

JORIN MITRAJ

